

V E N D I M
Nr.117, datë 27.2.2003

**PËR NJËSIMIN E FUNKSIONEVE NË POLICINË E SHTETIT ME FUNKSIONET
PËRKATËSE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 15 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Njësimin e funksioneve në Policinë e Shtetit me funksionet përkatëse në administratën publike, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Përshkrimi i vendeve të punës, sipas roleve dhe gradave, të bëhet sipas aneksit nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKS 1
TABELA E NJËSIMIT TË FUNKSIONEVE

Kategorizimi në role i punonjësve të policisë sipas nenit 15 pika 2 i ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”	Klasat e nëpunësve civil sipas nenit 11 pika 1 i ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”
Roli i mesëm	Nëpunës civil të nivelit të ulët drejtues
Roli i lartë	Nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues
Roli madhor	Nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues

ANEKS 2
**PËRSHKRIMI I VENDEVE TË PUNËS SIPAS ROLEVE DHE GRADAVE NË POLICINË
E SHTETIT**

a) Në gradat e rolit madhor përfshihen, gradat Drejtues i parë dhe Drejtues të barasvlefshme me funksionet Drejtor i Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm.

Disa nga detyrat funksionale për rolin madhor:

Këto funksione realizojnë drejtimin teknik dhe administrativ, bashkërendimin dhe kontrollin brenda Policisë së Shtetit, përfaqësojnë policinë në marrëdhënie me organe të tjera të administratës publike, me organizatat joqeveritare dhe me publikun brenda vendit, ndërsa në marrëdhëniet me jashtë sipas delegimit të ministrit. Nxjerr urdhërsërbime dhe letërporosi për ushtrimin e funksionit e të përgjegjësive të tij. Kryeson (Zëvendësdrejtori) komisionin e gradimeve për rolin e lartë.

Në gradat e rolit madhor janë të barasvlefshme dhe funksionet Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Drejtor i Akademisë së Policisë.

Këto funksione janë niveli më i lartë i menaxhimit të Policisë së Shtetit dhe kanë përgjegjësi për hartimin e politikave në një fushë të caktuar dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

b) Në gradat e rolit të lartë përfshihen, gradat Kryekomisar, Komisar, Nënkomisar të

barasvlefshme me funksionet, shef sektori në DPP, shef zyre në DPP, Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore, Drejtor i Policisë së Qarkut, Shef Komisariati i Policisë, etj.

Këto funksione bëjnë të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja politike për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e politikave në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare, të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Ky nivel bën të mundur gjithashtu dhe zgjidhjen e problemeve komplekse, që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha brenda institucionit.

c) Në gradat e rolit të mesëm përfshihen, gradat Kryeinspktor, Inspektor, Nëninspektor të barasvlefshme me funksionet, shefa sektori, shefa zyre, shefa seksioni, shefa nënseksioni, specialist në drejtoritë e policisë së qarqeve dhe komisariateve të policisë në repartet FS-së e FNSH-së etj..

Këto funksione merren me zbatimin e politikave ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve politike mbi një fushë të caktuar duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.